

Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale, 2022

Tiranë, më 27 Prill 2023: Në këtë publikim, statistikat e krimeve japin informacion mbi veprat penale, autorë të veprave penale, persona të dëmtuar, procedime penale, persona të pandehur dhe të dhëna mbi të burgosurit.

Vepra penale

Në vitin 2022, janë evidentuar gjithsej 33.476 vepra penale, 4,8 % më pak, krahasuar me vitin 2021.

Tab. 1 Vepra penale të evidentuara


Vepra penale	2018	2019	2020	2021	2022
Vrasje me dashje	51	58	52	61	42
Vrasje të mbetura në tentativë	114	93	114	101	93
Krime me dashje kundër shëndetit	2.493	2.449	2.521	2.176	1.823
Krime seksuale	110	155	146	136	169
Vjedhje (neni 134)	4.532	4.290	3.909	3.508	2.661
Vjedhje me dhunë	108	85	88	85	65
Vjedhje me armë	22	13	14	11	13
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	70	76	46	67	97
Mashtrime	1.040	959	876	975	1.062
Fallsifikim monedhash	82	84	86	67	51
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.374	1.341	1.505	1.631	1.887
Krime në fushën e drogës	1.907	1.989	2.086	3.078	2.887
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	5.713	5.652	5.300	5.854	5.682
Tjetër	16.852	17.966	15.993	17.425	16.944
Gjithsej	34.468	35.210	32.736	35.175	33.476

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Veprat penale Mashtrime, Dhuna në familje (neni 130/a), Krime seksuale, Vjedhje duke shpërdoruar detyrën dhe Vjedhje me armë janë rritur, krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa pjesa tjetër e veprave penale ka pësuar rënie.

Për publikim: 27 Prill 2023

Fig. 1 Ndryshimi në përqindje i veprave penale, 2022-2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Autorë të veprave penale

Në vitin 2022, janë regjistruar 38.198 autorë për vepër penale, 2,9 % më pak, krahasuar me vitin 2021. Numri i autorëve sipas veprave penale përfshin numrin e personave të dyshuar të cilët mund të jenë të pranishëm në më shumë se një vepër penale dhe autori numërohet në të gjitha veprat ku është i dyshuar. Ndërkohë, numri i autorëve pa përsëritje në veprat penale, në vitin 2022 është 32.420 autorë, 9,3 % më pak, krahasuar me vitin 2021.


Tab. 2 Autorë për vepër penale

Vepra penale	2018	2019	2020	2021	2022
Vrasje me dashje	60	78	70	67	36
Vrasje të mbetura në tentativë	149	113	139	150	115
Krime me dashje kundër shëndetit	3.264	3.279	3.342	2.964	2.433
Krime seksuale	114	162	165	142	178
Vjedhje(neni 134)	3.178	2.608	3.019	2.685	1.995
Vjedhje me dhunë	115	101	94	113	99
Vjedhje me armë	23	34	35	17	19
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	77	104	54	89	122
Mashtrime	1.033	983	954	1.088	1.281
Fallsifikim monedhash	77	69	69	98	54
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.459	1.438	1.604	1.733	2.003
Krime në fushën e drogës	2.357	2.703	3.202	3.793	3.609
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	5.530	5.473	5.128	5.672	5.538
Tjetër	22.213	25.900	23.081	20.717	20.716
Autorë Gjithsej	39.649	43.045	40.956	39.328	38.198
Autorë pa përsëritje të veprave penale	34.537	36.083	35.213	35.745	32.420

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Meshkujt përbëjnë 94,3 % të totalit të autorëve të veprave penale.


Fig. 2 Autorë gjithsej dhe autorë meshkuj për vepër penale



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Në vitin 2022, 36 % e autorëve janë të grupmoshës 30-44 vjeç, 26,7 % të grupmoshës 18-29 vjeç dhe 22 % i përkasin grupmoshës 45-59 vjeç.

Fig. 3 Autorë për vepër penale sipas grupmoshës, 2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Të dëmtuar

Në vitin 2022, janë regjistruar 13.650 persona të dëmtuar, 19,3 % më pak, krahasuar me vitin 2021. Personat e dëmtuar për krime kundër personit përbëjnë 40,5 % të totalit të personave të dëmtuar.


Tab. 3 Të dëmtuar

Të dëmtuar	2018	2019	2020	2021	2022
Krime kundër jetës	1.652	1.416	1.466	1.303	970
Krime kundër shëndetit	2.982	2.986	3.072	2.616	1.846
Krime seksuale	105	148	132	129	143
Vepra penale kundër lirisë së personit	173	181	143	120	144
Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit	335	321	305	313	268
Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes	1.736	1.652	1.772	1.881	2.119
Të tjera kundër personit	24	40	38	49	32
Të dëmtuar për krime kundër personit	7.007	6.744	6.928	6.411	5.522
Të dëmtuar gjithsej	19.101	18.858	17.829	16.910	13.650

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Në vitin 2022, 40 % e personave të dëmtuar për krime kundër personit ishin femra dhe përqindja më e madhe e tyre vihet re në Krime seksuale, Krime kundër fëmijëve, martesës dhe familjes si edhe Krime kundër moralit dhe dinjitetit.

Fig. 4 Të dëmtuar për krime kundër personit sipas gjinisë, 2022



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Procedime penale


Në vitin 2022, numri i procedimeve penale të regjistruara është 25.708 procedime, 9,3 % më pak, krahasuar me vitin 2021. Nga 25.853 procedime penale të përfunduara, 25,9 % e tyre janë pushuar, 30,7 % janë pezulluar dhe 43,4 % janë dërguar për gjykim në gjykatë.

Tab. 4 Procedime penale të regjistruara

Vepra penale	2018	2019	2020	2021	2022
Vrasje me dashje	126	137	128	117	93
Vrasje të mbetura në tentativë	52	28	35	48	35
Krime me dashje kundër shëndetit	908	903	861	823	667
Krime seksuale	113	158	136	158	162
Vjedhje (neni 134)	9.219	8.682	7.812	7.010	6.093
Vjedhja me dhunë	118	117	123	112	84
Vjedhja me armë	35	15	15	11	16
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	114	85	68	78	79
Mashtrime	872	745	627	752	696
Fallsifikim monedhash	80	82	75	62	42
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.209	1.140	1.251	1.406	1.453
Krime në fushën e drogës	1.524	1.548	1.793	2.069	1.585
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	4.121	4.038	3.911	4.374	4.385
Tjetër	12.898	13.017	11.017	11.329	10.318
Gjithsej	31.389	30.695	27.852	28.349	25.708

Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

Fig. 5 Progresi i procedimeve penale të përfunduara



Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

Të pandehur

Në vitin 2022, janë regjistruar 16.246 persona të pandehur, 0,3 % më shumë, krahasuar me vitin 2021. Veprat penale Vrasje me dashje, Dhuna në familje, Krimet në fushën e drogës, Shkelja e rregullave të

qarkullimit rrugor, Krime seksuale dhe Vjedhje me armë janë rritur, krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa pjesa tjetër e veprave penale ka pësuar rënie.


Tab. 5 Të pandehur

Vepra penale	2018	2019	2020	2021	2022
Vrasje me dashje	111	132	110	87	108
Vrasje të mbetura në tentativë	38	32	28	59	37
Krime me dashje kundër shëndetit	622	542	508	614	527
Krime seksuale	66	111	101	128	131
Vjedhje (neni 134)	1.299	1.078	979	1.102	1.041
Vjedhja me dhunë	73	70	73	85	57
Vjedhja me armë	13	18	14	9	13
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	68	86	42	68	62
Mashtrime	446	384	328	328	270
Fallsifikim monedhash	45	38	22	34	27
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.198	1.038	1.081	1.304	1.419
Krime në fushën e drogës	1.183	921	1.033	1.487	1.626
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	3.596	3.152	3.213	3.689	3.955
Tjetër	7.491	7.119	5.877	7.202	6.973
Gjithsej	16.249	14.721	13.409	16.196	16.246

Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

Meshkujt përbëjnë 94,7 % në totalin e personave të pandehur.

Fig. 6 Persona të pandehur sipas gjinisë



Burimi: Prokuroria e Përgjithshme

Të burgosur

Në vitin 2022, numri i të burgosurve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale është 4.944, 0,2 % më pak, krahasuar me vitin 2021. Meshkujt përbëjnë 98,7 % të totalit të të burgosurve.


Tab. 6 Të burgosur sipas veprave penale

Vepra penale	2018	2019	2020	2021	2022
Vjedhje	859	811	713	684	733
Vrasje	1.053	1.006	1.012	895	944
Plagosje	94	74	80	95	96
Krime seksuale	108	117	112	45	44
Krime në fushën e drogës	1.706	1.580	1.311	1.431	1.377
Organizata kriminale	52	78	71	70	79
Mashttrim	112	129	121	127	117
Shfrytëzim prostitucioni	78	67	51	44	41
Të tjera	1.254	1.183	1.143	1.565	1.513
Gjithsej	5.316	5.045	4.614	4.956	4.944

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Grupmosha 21-29 vjeç ka numrin më të lartë të të burgosurve. Personat mbi 60 vjeç dhe nën 20 vjeç kanë numrin më të ulët të të burgosurve.

Fig. 7 Të burgosur sipas grupmoshës



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Metodologjia

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nëpërmjet evidencës vjetore të detajuar sipas neneve të Kodit Penal, Prokuroria e Përgjithshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Të dhënat mbi statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx> Politika e revizionimit statistikor.

1. Vepra penale

Statistikat mbi veprat penale të evidentuara japin një pamje gjithëpërfshirëse të të gjithë rasteve të raportuara në polici. Ato tregojnë numrin e veprave penale që janë raportuar dhe evidentuar si vepra penale nga policia.

2. Autorë

Të dhënat mbi autorët bazohen në persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale. Totali i autorëve paraqet numrin e autorëve për vepër penale. Një autorë mund të jetë i pranishëm në më shumë se një vepër penale.

3. Persona të dëmtuar

Të dëmtuarit/viktimat e veprave penale i referohen personave të dëmtuar nga kryerja e një vepre penale gjatë një viti.

4. Procedime penale

Statistikat mbi procedimet penale paraqesin të dhëna për procedimet penale të regjistruara, pushuara, pezulluara dhe procedimet penale të dërguara për gjykim.

Procedime të regjistruara janë procedimet që kanë filluar të hetohen në vitin korrent. Procedime të pushuara janë procedimet për të cilat prokurori në përfundim të hetimeve paraprake vendos vetë ose i kërkon gjykatës pushimin e çështjes ose akuzës, kur janë rastet e parashikuara nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale. Procedime të pezulluara janë vendimmarrjet e prokurorit në rastet kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm. Statistikat mbi procedimet penale për gjykim paraqesin numrin e çështjeve të dërguara në gjykatë për gjykim të një personi të akuzuar ose që do të akuzohet për kryerjen e një vepre penale.

5. Të pandehur

Statistikat për të pandehurit paraqesin të dhëna për numrin e të pandehurve të rinj që u nënshtrohen procedimeve penale për gjykim gjatë vitit referues. Në sistemin e drejtësisë, në këtë fazë ata nuk janë më persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale, siç ishin në polici por janë persona të akuzuar. Për qëllime statistikore, në totalin e të pandehurve janë shtuar të dhëna edhe për personat nën hetim.

6. Të burgosur

Të dhënat për personat në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale i referohen numrit gjithsej të personave të dënuar me burg dhe të paraburgosur, në burgje, qendrat e paraburgimit, institucionet e burgosjes së të miturve si edhe spitale të burgut, deri në dhjetor të çdo viti. Të dënuar me burg i referohet personave që ndodhen në burgje, të cilët kanë marrë dënimin përfundimtar me burgim. Të paraburgosur i referohet personave që janë në qendrat e paraburgimit dhe në burgje, ndaj të cilëve është marrë masë sigurimi “arrest në burg”.

Përkufizime

Vrasje me dashje: Vepër e kundraligjshme, me anë të së cilës i hiqet jeta një personi tjetër me dashje. Përshihen veprat penale si: Neni 76 Vrasje me dashje, Neni 77 Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër, Neni 78 Vrasje me paramendim, Neni 78/a Vrasje për gjakmarrje, Neni 79 Vrasje në rrethana cilësuese, Neni 79/a Vrasje e funksionarëve publik, Neni 79/b Vrasja e punonjësve të policisë së shtetit, Neni 79/c Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, Neni 81 Vrasje e foshnjës.

Krime seksuale: Përfshihen nenet 100-108/a të Kodit Penal.

Vjedhje me dhunë: Përfshihet neni 139 i Kodit Penal.

Krime me dashje kundër shëndetit: Përfshihen nenet 86-90 të Kodit Penal.

Mashtrime: Përfshihen nenet 143-149/b të Kodit Penal.

Fallsifikim monedhash: Përfshihet neni 183 i Kodit Penal.

Krime në fushën e drogës: Përfshihen veprat penale si: Neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve, Neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike, Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope.

Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor: Përfshihen veprat penale si: Neni 290 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, Neni 291 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor në gjendje të dehur, pa dëshmi, Neni 273 Largim nga vendi i aksidentit.